FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 85

Tiranë – E mërkurë, 22 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 231, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7607
Dekret i Presidentit nr. 232, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7607
Dekret i Presidentit nr. 233, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7607
Dekret i Presidentit nr. 234, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7607
Dekret i Presidentit nr. 235, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7608
Dekret i Presidentit nr. 236, datë 16.4.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7608
Dekret i Presidentit nr. 237, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7608
Dekret i Presidentit nr. 238, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7609
Dekret i Presidentit nr. 239, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7609
Dekret i Presidentit nr. 240, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7609
Dekret i Presidentit nr. 241, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7610

Dekret i Presidentit nr. 242, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7610
Dekret i Presidentit nr. 243, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7610
Dekret i Presidentit nr. 244, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7610
Dekret i Presidentit nr. 245, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7611
Dekret i Presidentit nr. 246, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7611
Dekret i Presidentit nr. 247, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7611
Dekret i Presidentit nr. 248, datë 16.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7612
Dekret i Presidentit nr. 252, datë 17.4.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	7612
Dekret i Presidentit nr. 253, datë 17.4.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	7612
Dekret i Presidentit nr. 254, datë 17.4.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	7613
Dekret i Presidentit nr. 255, datë 17.4.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	7613
Dekret i Presidentit nr. 257, datë 17.4.2026	Për dhënie dekorate.....	7613
Dekret i Presidentit nr. 258, datë 17.4.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	7614
Dekret i Presidentit nr. 259, datë 17.4.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	7614
Dekret i Presidentit nr. 260, datë 17.4.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	7614
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 17.4.2026	Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit dhe përcaktimin e kompetencave të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit e të Koordinatorit Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin.....	7615
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 17.4.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	7619

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 17.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollën 'Mustafa Grebllleshi' dhe 'Sandër Prosi'", Bashkia Tiranë.....	7620
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 17.4.2026	Për miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme	7622
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 17.4.2026	Për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.....	7630
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 17.4.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 752, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale", të ndryshuar.....	7637
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 17.4.2026	Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambël arkitektonik urban" të një zone në qytetin e Delvinës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të tij dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.....	7637
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 17.4.2026	Për deklarimin "Pasuri kulturore e paluajtshme" të zonës arkeologjike "A" të Bushatit, Bashkia Vau i Dejës, dhe miratimin e zonifikimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e saj.....	7647
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 287, datë 17.4.2026	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2026.....	7651
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 403, datë 15.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	7654
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 405, datë 16.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Kosovës.....	7655
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 406, datë 16.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	7656

DEKRET
Nr. 231, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Arbra Eduard Kraja
2. Olsi Petrit Baholli
3. Kejsi Dritan Pröll

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 232, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:
1. Ergi Fisnik Xhepi
2. Dardi Lavdosh Zuna
3. Keisi Bashkim Grublleshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 233, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Selma Xhafer Friedhuber

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 234, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Luljeta Hamid Selmanllari
2. Meivis Edison Selmanllari
3. Livi Edison Selmanllari
4. Fotiola Thoma Xhimitiku
5. Alto Viktor Delia
6. Esli Benard Zoto

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 235, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Elektra Mersim Iliazi
2. Orion Ervin Iliazi
3. Aleksandra Ervin Iliazi
4. Ervin Agim Iliazi
5. Erlin Vehbi Baftseferi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 236, datë 16.4.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Driti Adrian Jasimi
2. Eduart Hysko Çemeri
3. Erik Genc Iljazi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 237, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Walid Ahmed Kamel Elsayed Elkafrawy

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 238, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Ali Raif Raif Ali Dinçkök

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 239, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Johan Jörg Jörg Klaus Feyler

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 240, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Fatma Gülgün Zeki Bilge

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 241, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Haki Ramadan Luma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 242, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Jonathan Ryan Michael Kanaan Daye

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 243, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Berker Ali Yusuf Mart

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 244, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Carolin Sigrid Helmut Feyler

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 245, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Eman Abdelrahman Elnachar Mohamed Wasfy Abdelrahman

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 246, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ibrahim Hakki Zeki Bilge

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 247, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ahmed Mohamed Abdelmonem Omar

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 248, datë 16.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Banush Hamdi Xheladini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 252, datë 17.4.2026

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Riza Poda lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës, rezident, si dhe nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Bangladeshit, në Republikën Popullore Demokratike të Koresë, në Republikën Socialiste të Vietnamit, në Mongoli dhe në Mbretërinë e Tajlandës, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 253, datë 17.4.2026

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bardhyl Canaj lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Serbisë, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 254, datë 17.4.2026

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sami Shiba lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Arabe të Egjiptit, rezident, si dhe nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Arabe të Sirisë, në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë, Shtetin e Libisë, Shtetin e Palestinës, Republikën Libaneze dhe në Republikën e Sudanit, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 255, datë 17.4.2026

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Vasilika Hysi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara dhe Organizatave të Tjera Ndërkombëtare në Gjenevë, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 257, datë 17.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 9 dhe 22 të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë",

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës "Komandar i Urdhrit të Lisit Akademik"
zotit Hasan Uğur Ulusoy

"Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e tyre në përparimin akademik dhe sportiv të të rinjve shqiptarë, veçanërisht në fushën e shëndetësisë dhe të shahut, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm në vepra bamirësie".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 258, datë 17.4.2026

PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Albana Dautllari lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës, rezident, si dhe nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Dukatin e Madh të Luksemburgut, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 259, datë 17.4.2026

PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Albana Dautllari emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 260, datë 17.4.2026

PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2 të ligjit nr. 24/2026, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Gazmend Barbullushi emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Dukatin e Madh të Luksemburgut, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 273, datë 17.4.2026

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM-SHPËTIMIT DHE PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM-SHPËTIMIT E TË KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR KËRKIM-SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 2, e 7, pika 2, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore dhe detare", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, si dhe përcaktimi i kompetencave të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit e të Koordinatorit Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është garantimi i një sistemi të unifikuar kombëtar për menaxhimin, drejtimin e koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit

1. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (në vijim, QKKSH-ja) është institucion publik buxhetor në varësi të ministrit të Mbrojtjes.

2. QKKSH-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. QKKSH-ja organizohet në nivel qendror, me seli në Tiranë.

4. Rregullorja, që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të QKKSH-së, miratohet nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e kryetarit të QKKSH-së.

5. QKKSH-ja ka stemën, vulën e vet zyrtare dhe logon. Vula ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare", të ndryshuar. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

Neni 4
Kryetari i QKKSH-së

1. Kryetari i QKKSH-së siguron drejtimin e veprimtarisë së qendrës dhe ushtron kompetencat në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin e kërkim-shpëtimit.

2. Kryetari i QKKSH-së, përveç sa parashikohet në ligj, ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) I propozon ministrit të Mbrojtjes, për miratim, tabelën e organizimit dhe të pajisjeve të QKKSH-së;

b) I propozon ministrit të Mbrojtjes, për miratim, vendin e vendosjes, objektin dhe infrastrukturën e përshtatshme për personelin, pajisjet dhe instalimet e tjera të nevojshme, në përmbushje të misionit të QKKSH-së;

c) Raporton te ministri i Mbrojtjes, sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit, për veprimtarinë e QKKSH-së;

ç) Përfaqëson QKKSH-në në marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe subjektet private, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje;

d) Monitoron zbatimin e strategjive dhe të planeve në përputhje me detyrimet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit;

dh) Kryen çdo funksion tjetër të nevojshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kryetar i QKKSH-së emërohet personi, i cili mund të jetë me status ushtarak ose joushtarak.

Neni 5
Kriteret për përzgjedhjen e kryetarit të QKKSH-së

1. Emërimi i kryetarit të QKKSH-së, në rast se është me status ushtaraku, bëhet nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Është oficer me gradën "Kolonel";

b) Ka kryer kurse dhe kualifikime të ndryshme ushtarake për formimin e përgjithshëm dhe atë profesional;

c) Ka mbaruar kursin e lartë të oficerit;

ç) Ka kryer kurse në fushën e kërkim-shpëtimit, që mbulon aksidentet ajrore ose detare;

d) Ka eksperiencë punë si drejtues në struktura ushtarake;

dh) Zotëron gjuhën angleze;

e) Nuk ka konflikt interesi me detyrën ose funksionin që kryen, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

2. Emërimi i kryetarit të QKKSH-së, në rast se është joushtarak, bëhet nga ministri i Mbrojtjes dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

a) Është shtetas shqiptar;

b) Ka zotësi të plotë për të vepruar;

c) Është i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

ç) Zotëron diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo "Master profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike;

d) Ka të paktën 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në punë;

dh) Nuk i është hequr e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

ë) Plotëson kushtet e sigurisë për kontrollin e verifikimit të pasurisë e të figurës;

f) Nuk është larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike, si dhe nuk ka marrë masë disiplinore, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

g) Zotëron gjuhën angleze;

gj) Nuk ka konflikt interesi me detyrën ose funksionin që kryen, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesit.

Neni 6
Lirimi nga detyra i kryetarit të QKKSH-së

1. Kryetari i QKKSH-së lirohet nga detyra në rastet kur:

a) plotëson moshën për pension pleqërie;

b) jep dorëheqjen nga detyra;

c) humbet shtetësinë shqiptare;

ç) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

d) emërohet në një detyrë tjetër;

dh) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

e) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Në rast se kryetari i QKKSH-së është me status ushtaraku, përveç sa më lart, mund të lirohet nga detyra dhe nëse plotëson kohën e qëndrimit në shërbim në Forcat e Armatosura.

Neni 7
Shkarkimi nga detyra i kryetarit të QKKSH-së

1. Kryetari i QKKSH-së shkarkohet nga detyra në rastet kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) kryen veprimtari që krijon konflikt interesi, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesit;

c) i hiqet ose i refuzohet certifikata e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

d) në rastet e moszbatimit haptazi të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale;

dh) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë pune në vijim;

e) nuk përmbush objektivat e punës.

2. Në rast se kryetari i QKKSH-së është me status ushtaraku, përveç sa më lart, mund të shkarkohet nga detyra dhe nëse kryen akte dhe sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën e ushtarakut të Forcave të Armatosura.

Neni 8
Punonjësi i QKKSH-së

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve joushtarakë të QKKSH-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i personelit joushtarak bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i personelit ushtarak bëhet sipas legjislacionit në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Parimet bazë mbi të cilat mbështetet përzgjedhja e punonjësit, janë formimi arsimor, profesional, pastërtia e figurës, përvoja e tij dhe specifikat e pozicionit të punës.

Neni 9
Buxheti i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

Buxheti i QKKSH-së përbën zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 10
Marrja e informacionit në rast të emergjencave të kërkim-shpëtimit

1. Emergjencat e kërkim-shpëtimit vijnë nga:

a) satelitët e sistemit COSPAS-SARSAT, që kapin sinjalet nga pajisjet sinjalizuese ELT/ELT-DT (transmetimi i vendndodhjes së emergjencës, gjurmim i sinjalit të rrezikut për avionët), EPIRB (fener radio për sinjalizimin e pozicionit në rast emergjence për mjetet detare) dhe PLB (pajisje personale për sinjalin e pozicionit në rast emergjence për individ);

b) Albcontrol-i;

c) Qendra e Kontroll-Raportimit të Komandës së Forcës Ajrore;

ç) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare;

d) Komanda e Forcës Detare;

dh) thirrjet direkte nga anijet, avionët ose individët në rrezik përmes sistemit global të sinjalizimit të rrezikut dhe të sigurisë detare (GMDSS), radiostacioneve me frekuencë shumë të lartë dhe me frekuencë të lartë ose telefonisë satelitore;

e) struktura të tjera shtetërore.

2. Pas pranimit të sinjalit të alarmit, QKKSH-ja verifikon vërtetësinë e tij, lokalizon aksidentin dhe fillon analizën e rrethanave për të vendosur llojin e përgjigjes që duhet të jepet.

3. QKKSH-ja është pika e kontaktit për emergjencat e kërkim-shpëtimit, e cila funksionon pa ndërprerje 24 (njëzet e katër) orë në 7 (shtatë) ditë të javës.

Neni 11
Marrëdhëniet e bashkëpunimit

1. Në varësi të informacionit të marrë dhe llojit të aksidentit të ndodhur, QKKSH-ja koordinon bashkëpunimin me strukturat dhe njësitë, të cilat kanë deklaruar kapacitete operacionale kërkim-shpëtimi në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

2. Pas verifikimit të sinjalit të alarmit të emergjencës ajrore apo detare, QKKSH-ja merr masat për koordinimin e veprimeve, në varësi të sinjalit të marrë, me:

a) njësitë/ekuipazhet e Forcës Ajrore apo të Forcës Detare;

b) Policinë e Shtetit;

c) Urgjencën Kombëtare Mjekësore;

ç) Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;

d) struktura të tjera të përcaktuara në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. QKKSH-ja mbikëqyr zhvillimin e operacionit dhe rregullon strategjinë bazuar në informacionet e reja.

4. QKKSH-ja bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për shfrytëzimin e kapaciteteve të deklaruara në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe për shkëmbimin e informacionit në rastet e emergjencave civile dhe SAR.

Neni 12
Koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat rajonale e ndërkombëtare

1. QKKSH-ja merr pjesë në takimet e në aktivitetet stërvitore, trajnuese dhe promovuese me vendet, me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet në fushën e kërkim-shpëtimit.

2. Në rastin e një aksidenti ajror në ujërat e brendshme afër kufijve ose në ujërat ndërkombëtare, QKKSH-ja kontakton qendrat e koordinimit të kërkim-shpëtimit të vendeve fqinje për koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, në zbatim të konventave ndërkombëtare dhe të marrëveshjeve të nënshkruara.

Neni 13
Bashkëpunimi me koordinatorët kombëtarë të ajrit dhe të detit

1. QKKSH-ja koordinon në nivel kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

2. QKKSH-ja e ushtron aktivitetin e saj operacional nëpërmjet:

a) Qendrës Ajrore të Kërkim-Shpëtimit, e cila kryen edhe rolin e Qendrës Ajrore të Koordinimit të Shpëtimit;

b) Qendrës Detare të Kërkim-Shpëtimit, e cila kryen dhe rolin e Qendrës Detare të Koordinimit të Shpëtimit;

c) institucioneve/strukturave të tjera të parashikuara në Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

3. QKKSH-ja e operon sistemin e kërkim-shpëtimit nëpërmjet strukturave të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij neni.

Neni 14
Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit

QKKSH-ja, përveç sa parashikohet në ligj, ka dhe kompetencat e mëposhtme:

a) Zbaton Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë;

b) Bashkëpunon me vendet fqinje për incidentet që ndodhin pranë ose në vijën kufitare;

c) Zbaton marrëveshjet e nënshkruara me institucionet shtetërore, subjektet private dhe strukturat rajonale në fushën e kërkim-shpëtimit;

ç) Vlerëson aktivitetin e shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe përcakton përparësitë e ndërhyrjeve në rastet e operacioneve të shpëtimit të jetës njerëzore;

d) Mban kontakte të drejtpërdrejta dhe bashkëpunon me qendrat rajonale të kërkim-shpëtimit të vendeve fqinje, sipas konventave ndërkombëtare e rajonale të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacionit kombëtar në fushën e kërkim-shpëtimit;

dh) Koordinon e bashkërendon veprimet me institucionet shtetërore dhe subjektet private, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e kërkim-shpëtimit;

e) Aktivizon, sipas fushës së përgjegjësisë, koordinatorët dhe njësitë/ekuipazhet kombëtare SAR për ndërhyrje, kryerje të operacioneve të kërkim-shpëtimit në tokë, në det dhe në ujërat e brendshme;

ë) Vendos në dispozicion të strukturave kombëtare reaguese të gjitha asetet e nevojshme për realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit;

f) Përgatit plane, udhëzime, procedura standarde operacionale për marrjen, shkëmbimin, vlerësimin e informacionit, angazhimin në operacion, si dhe modulet e trajnimit për kapacitetet kombëtare të deklaruara për kërkim-shpëtim;

g) Planifikon kërkesat për mjete, materiale, pajisje kërkim-shpëtimi dhe nevojat për përdorimin sa më racional të burimeve e mjeteve të deklaruara në interes të realizimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit;

gj) Kontrollon zbatimin e planit operacional kombëtar për operacionet e kërkim-shpëtimit, në rast incidenti ajror e detar;

h) Merr pjesë në grupin ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë;

i) Menaxhon informacionin e prodhuar nga Qendra Ajrore e Kërkim-Shpëtimit dhe Qendra Detare e Kërkim-Shpëtimit;

j) Siguron mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit të nevojshëm për koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe informimin sipas linjës së komandim-kontrollit dhe strukturave të tjera përkatëse.

Neni 15
Kompetencat e Koordinatorit Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin

1. Koordinatori Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin në Republikën e Shqipërisë është shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Koordinatori Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin, përveç sa parashikohet në ligj, ka dhe përgjegjësitë, si më poshtë:

a) drejton Komitetin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

b) siguron përdorimin e kapaciteteve ajrore, detare dhe tokësore në operacionet e kërkim-shpëtimit;

c) raporton, të paktën një herë në vit dhe sa herë që i kërkohet, te ministri i Mbrojtjes për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë;

ç) koordinon me institucionet shtetërore, institucionet ndërkombëtare për sigurimin e një reagimi të shpejtë dhe efikas, në rast aksidentesh ajrore dhe detare.

Neni 16
Dispozita të fundit

1. Vendimi nr. 742, datë 16.10.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit", shfuqizohet.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit dhe Koordinatori Kombëtar për Kërkim-Shpëtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM
Nr. 274, datë 17.4.2026

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", shtohen 3 (tre) individë të renditur në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

SHTESA NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
("LISTA E OKB-së")
C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe Al-QAIDA

a) Shtesa në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida";

1. SAMI: JASIM: MUHAMMAD JAATA: AL-JABURI
2. ABD EL HAMID: SALIM: IBRAHIM BRUKAN: AL-KHATOUNI
3. HAMIDAH: NABAGALA

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

VENDIM
Nr. 277, datë 17.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE DHE MURI RRETHUES PËR SHKOLLËN 'MUSTAFA GREBLLESHI' DHE 'SANDËR PROSI'", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollën 'Mustafa Grebllleshi' dhe 'Sandër Prosi'", Bashkia Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 62 092 322.50 (gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 62 092 322.50 (gjashtëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim për çdo pasuri, objekt shpronësimi, do të kërkohet dokumentacion pronësie i rifreskuar për secilin pronar, të konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim verifikimin e kufizimeve përkatëse, që mbartin kartelat e pasurive, në bazë të të cilave do të vlerësohet dhe do të bëhet procedura e ekzekutimit të këtij vendimi, si dhe në rast se prona është në proces gjyqësor, masa e shpërblimit ose e kompensimit do të vendoset në dispozicion të personit, që rezulton nga vendimi i formës së prerë të gjykatës.

9. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE DHE MURI RRETHUES PËR SHKOLLËN 'MUSTAFA GREBLLESHI' DHE 'SANDËR PROSI', BASHKIA TIRANË

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)									Vlerësimet për shpronësim							SHËNIME BAZUAR NË KARTELËN E PASURISË TË PALUAJTSHME: (Seksioni "C" – Të drejta reale)/(Seksioni D – "Kufizimet e pronësisë")/(Seksioni "E" – Informacione të tjera për pronën)/(Seksioni "F" – Veprimet mbi kartelën e pasurisë)
													Truall			Ndërtesë				
	EMËR	Atësia	Mbiemër	Qyteti/ fshati	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sip. truall (m²)	Sip. ndërtese (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m²)	vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	
1	Roland	Enver	Hysa	Tiranë	8190	14/733	truall	2046	2046	0	52	7	93	33,755.00	3,139,215.00				3,139,215.00	
2	Aleksander	Preng	Bardhi	Tiranë	8190	14/300	truall	400	400	0	10	218	167.1	33,755.00	5,640,460.50				5,640,460.50	
3	Genci	Hamdi	Koçi	Tiranë	8190	14/309	truall	422	422	0	12	232	40.4	33,755.00	1,363,702.00				1,363,702.00	
4	Agime Dallendyshe Fatmir Flutura Gezim Mahmudije Nazmie Rexhep Shefki		Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla Balla	Tiranë	8190	14/273		2850	2850	0	8	227	66.2	33,755.00	2,234,581.00				2,234,581.00	
5	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/668	truall	68	68	0	36	52	60.6	33,755.00	2,045,553.00				2,045,553.00	
6	Zenel	Hasan	Tresa	Tiranë	8190	14/669	truall	172	172	0	36	53	36.6	33,755.00	1,235,433.00				1,235,433.00	
7	Pranvera Ilir Liljana Arben Suzana Shqipe	Fadil Fadil Fadil Fadil Fadil Fadil	Sula Balla Doma Balla Foto Gerollari	Tiranë	8190	14/737	truall	3533	3533	0	53	113	536.6	33,755.00	18,112,933.00				18,112,933.00	
8	Besim	Abdulla	Mata	Tiranë	8190	14/736	truall	850	850	0	53	112	25.8	33,755.00	870,879.00				870,879.00	
9	Dritan	Mehdi	Beti	Tiranë	8190	14/686	truall	417	417	132.9	42	188	27.8	33,755.00	938,389.00				938,389.00	
10	Lulëzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/252	truall	2184	2184	143.5	5	93	397.2	33,755.00	13,407,486.00				13,407,486.00	
11	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/672	truall	3290	3290	0	36	56	214	33,755.00	7,223,570.00				7,223,570.00	
12	Besim	Abdulla	Mata	Tiranë	8190	14/272	truall	400	400	0	8	228	20.3	33,755.00	685,226.50				685,226.50	
13	Atnan	Ferdi	Spahiu	Tiranë	8190	14/670	truall	600	600	0	36	54	38	33,755.00	1,282,690.00				1,282,690.00	
14	Alush Hajri	Zeqir Zeqir	Gjorgji Gjorgji	Tiranë	8190	14/311	truall	466	466	0	13	99	7.7	33,755.00	259,913.50				259,913.50	
15	Ajet		Gjorgji	Tiranë	8190	14/310	truall	580	580	0	13	98	48.9	33,755.00	1,650,619.50				1,650,619.50	
16	Lulzim	Mustafa	Balla	Tiranë	8190	14/314	truall	36	36	0	13	164	17	33,755.00	573,835.00				573,835.00	
17	Bajram	Nuhi	Duraku	Tiranë	8190	14/671	truall	500	500	0	36	55	42.3	33,755.00	1,427,836.50				1,427,836.50	
	VLERA TOTALE																		**62,092,322.50**	

VENDIM
Nr. 279, datë 17.4.2026

PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR SIGURIMIN E VAZHDUESHMËRISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË SITUATA TË JASHTËZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 174, të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

MASAT
PËR SIGURIMIN E VAZHDUESHMËRISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË SITUATA TË JASHTËZAKONSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Ky dokument përcakton masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, me qëllim përballimin e situatave të jashtëzakonshme, duke:

a) minimizuar ndikimin e situatave të jashtëzakonshme në marrjen e shërbimeve të komunikimeve nga përdoruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike;

b) siguruar rikuperimin e shpejtë dhe të sigurt të funksioneve kritike të komunikimeve pas një ndërprerjeje të mundshme;

c) siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme.

2. Ky dokument ka për qëllim sigurimin e bashkërendimit të masave dhe të bashkëpunimit për përballimin e situatave të jashtëzakonshme në rrjetet e në shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Masat e përcaktuara në këtë dokument zbatohen për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për ofrimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, bazuar në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3
Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", për qëllime të këtij dokumenti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Situatë e jashtëzakonshme", dëmtimet e rënda të rrjetit të komunikimeve elektronike, fatkeqësitë natyrore, gjendja e emergjencës civile ose gjendja e luftës;

b) "Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile (KNEC)", një organ i përkohshëm, që krijohet menjëherë pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas përcaktimeve në ligjin për emergjencat civile;

c) "Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)", i njëjti kuptim sipas përcaktimeve në ligjin për emergjencat civile;

ç) "AKSK", Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, organ publik përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e ligjit për sigurinë kibernetike.

Neni 4
Detyrimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

1. Në situatat e jashtëzakonshme, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe AKEP-in, me qëllim zbatimin e masave të emergjencës dhe koordinimin me:

a) Komitetin Ndërministror të Emergjencave Civile (KNEC);

b) Komitetin e Mbrojtjes Civile (KMC);

c) Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

ç) autoritetet, strukturat e tjera përgjegjëse të ngritura në rastet e emergjencave kombëtare, në përputhje me ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile.".

2. Në rastin e incidenteve apo të sulmeve kibernetike, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bashkëpunojnë me AKEP-in dhe AKSK-në, sipas parashikimeve ligjore për sigurinë kibernetike dhe rregullat për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve sipas ligjit për komunikimet elektronike.

Neni 5
Plani i masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve

1. Për menaxhimin e vazhdimësisë së shërbimeve, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike krijojnë e mbajnë plane emergjence dhe një strategji për të siguruar vazhdimësinë e rrjeteve të komunikimit dhe të sistemeve të informacionit.

2. Plani i masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve dhe mirëfunksionimin e infrastrukturës së tyre në rastet e jashtëzakonshme, që hartohet nga sipërmarrësi i komunikimeve elektronike, përmban minimalisht parashikimet, si më poshtë:

a) Përcaktimin e qëllimit dhe të fushëveprimit të planit të masave;

b) Përcaktimin e objektivave të planit;

c) Përcaktimin e strukturave përgjegjëse organizative, si:

i. ekipin e menaxhimit të krizës;

ii. ekipin e vlerësimit të dëmtimeve dhe analizës së ndikimit në proces;

iii. ekipin e mbështetjes teknike, që zbaton procedurat teknike të rikuperimit;

iv. ekipin e komunikimit;

v. ekipin e sigurisë së informacionit;

ç) Përgjegjësitë e strukturave përkatëse për situatat e jashtëzakonshme;

d) Procesin e analizimit dhe identifikimit të sistemeve kritike;

dh) Strategjitë e kopjeve rezervë të të dhënave;

e) Infrastrukturën e rikuperimit;

ë) Procedurat e rikuperimit;

f) Planin e komunikimit dhe të koordinimit;

g) Testimin e mirëmbajtjen e planit;

gj) Aspektet ligjore, përputhshmërinë me standardet e sigurisë, reagimit në situata të emergjencave;

h) Trajnimin dhe ndërgjegjësimin e stafit;

i) Rishikimin periodik të planit.

3. Një model orientues për hartimin e planit të masave nga sipërmarrësit jepet në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij dokumenti.

Neni 6
Masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimit

1. Masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme përfshijnë masat:

a) parandaluese, përgatitore për situata të jashtëzakonshme;

b) gjatë situatës së jashtëzakonshme;

c) e rikuperimit pas situatës së jashtëzakonshme.

2. Masat për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve përfshijnë, gjithashtu, masat parandaluese, të vazhdimësisë dhe të rikuperimit, në rastin e incidenteve apo të sulmeve kibernetike. Lista e masave dhe kërkesat për dokumentimin e tyre jepen në anekset 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij dokumenti.

Neni 7
Masat parandaluese

1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike hartojnë dhe mirëmbajnë:

a) planin e vazhdimësisë së biznesit (PVB);

b) planin e rikuperimit pas fatkeqësisë (PRF).

2. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike identifikojnë e raportojnë pranë AKEP-it asetet dhe burimet kritike të rrjetit, si dhe pajisjet e lëvizshme, që disponojnë për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimit në raste të jashtëzakonshme,

brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve në situatë të jashtëzakonshme, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike zbatojnë standardet e sigurisë, duke marrë masat, si më poshtë:

a) Instalojnë linja rezervë, servera pasivë, mjete komunikimi të bazuara në teknologjinë *cloud* dhe lidhje të pavarura për stacionet bazë e shërbimet kritike;

b) Pajisin qendrat e të dhënave, stacionet dhe antenat transmetuese me burime alternative të furnizimit me energji;

c) Sigurojnë funksionalitetin e shërbimeve të emergjencës dhe të numrit "112" edhe pa kartë SIM.

4. Sipërmarrësit duhet të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse në ushtrimet kombëtare të simulimit të organizuara.

5. Operatorët duhet të caktojnë një person kontakti për 24 orë/7 ditë gjatë situatave të jashtëzakonshme, duke përditësuar të dhënat e kontaktit në AKEP.

Neni 8

Masat e reagimit gjatë situatës së jashtëzakonshme

1. Në rastin e situatave të jashtëzakonshme, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike aktivizojnë menjëherë ekipet e brendshme të menaxhimit të krizës, të situatave të emergjencës dhe njoftojnë pa vonesë AKEP-in për çdo ndërprerje të shërbimeve.

2. Sipërmarrësit marrin masa për aktivizimin e kanaleve prioritare për komunikimin e institucioneve shtetërore për emergjencat dhe, sipas rastit, vendosin në operim pajisjet lëvizëse të rrjetit për mbulimin me shërbim, si dhe sigurojnë transmetimin e paralajmërimeve publike për emergjencat civile apo fatkeqësitë e mëdha në zhvillim ose të pritshme, drejt përdoruesve fundorë të prekur përkatësisht.

3. Aktivizojnë burimet alternative të energjisë për qendrat e të dhënave, stacionet dhe antenat transmetuese.

4. Përdorin rirrugëzimin automatik të lidhjeve përmes lidhjeve rezervë, përfshirë dhe ato ndërkombëtare.

5. Marrin masa për përdorimin e sistemeve satelitore për mbulimin me sisteme komunikimi për autoritetet.

6. Sigurojnë akses për përdoruesit në shërbimet bazë të emergjencës.

7. Gjatë situatës së jashtëzakonshme, raportojnë çdo 4 (katër) orë pranë ministrisë përgjegjëse dhe AKEP-it.

Neni 9

Masat e rikuperimit pas situatës së jashtëzakonshme

1. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bëjnë vlerësimin dhe raportojnë në AKEP për dëmet brenda 48 orëve pas ngjarjes.

2. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të rikthejnë funksionalitetin e rrjetit, në përputhje me planin e rikuperimit, sipas nenit 7 të këtij dokumenti.

3. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të kryejnë një analizë pas ngjarjes me AKEP-in dhe institucionet e sigurisë.

4. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të përditësojnë planet PVB/PRF dhe të raportojnë tek AKEP-i.

5. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike ndërtojnë një manual praktik për përmirësim të kapaciteteve reaguese në të ardhmen.

Neni 10

Masat për sigurinë në rastet e incidenteve apo të sulmeve kibernetike

1. Pa anashkaluar zbatimin e masave, sipas parashikimeve në nenin 20, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", si dhe në nenet 54 e 157, të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", në kuadër të masave për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe të shërbimeve, me qëllim përballimin e situatave në rastet e sulmeve kibernetike, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike marrin masat, si më poshtë:

a) të kryejnë vlerësime periodike të rrezikut kibernetik çdo 12 muaj;

b) të kenë në funksionim sisteme të monitorimit e të analizës (SIMNJ/QOS) për detektimin e anomalive;

c) të zbatojnë arkitekturën "Zero besim", me akses të kufizuar sipas funksioneve;

ç) të mbajnë kopje rezervë *offline* të sistemeve dhe të konfigurimeve kritike;

d) të kryejnë testime dhe simulime për skenarë emergjencash kibernetike;

dh) të kenë një plan të shkruar të reagimit ndaj incidenteve (PRI), sipas kërkesave të AKSK-së.

2. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike aktivizojnë kanale të sigurta të komunikimit me autoritetet dhe duhet të realizojnë kriptimin e detyrueshëm të të gjitha lidhjeve të transmetimit.

3. Në rastin e incidenteve, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike kryejnë izolimin e pjesëve të kompromentuara të rrjetit, respektojnë standardet e sigurisë për kontrollin e aksesit, si dhe kryejnë auditim dhe analizë të plotë teknike të incidentit.

4. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike hartojnë raportin e incidentit dhe e paraqesin në AKEP dhe AKSK jo më vonë se 72 orë.

5. Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike rishikojnë periodikisht politikat e brendshme të sigurisë, planet e vazhdimësisë së biznesit dhe planet e reagimit ndaj incidenteve, si dhe kryejnë rregullisht trajnimin e stafit për sigurinë kibernetike.

Neni 11
Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në rastet e jashtëzakonshme dhe sipas nevojës, bazuar në Konventën Tampere dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit, ku Shqipëria është palë, ministria përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe AKEP-i, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse, mund të kërkojnë ndihmë nga partnerët ndërkombëtarë, vendet pjesëmarrëse në Konventën Tampere, për sigurimin e pajisjeve të komunikimit të lëvizshme, përfshirë mbulimin me komunikime satelitore, me qëllim sigurimin e shërbimeve të telekomunikacionit, sipas përcaktimeve në Konventën Tampere.

Neni 12
Autorizimet e përkohshme për rastet e situatave të jashtëzakonshme

Me qëllim përballimin e situatave të jashtëzakonshme, AKEP-i, sipas parashikimeve në ligjin për komunikimet elektronike dhe Planin Kombëtar të Frekuencave, ka të drejtë të japë autorizime të përkohshme për përdorimin e frekuencave rezervë për rastet e emergjencave, me qëllim sigurimin e komunikimeve elektronike.

Operatorët që veprojnë në fushën e ndihmës ndërkombëtare, në rastin e marrjes së ndihmës përmes Konventës Tampere, parashikuar në nenin 11 të saj, mund të pajisen me autorizim të përkohshëm për përdorimin e pajisjeve dhe të frekuencave, sipas një procedure të përshpejtuar.

Neni 13
Koordinimi operacional dhe pika kombëtare e kontaktit

1. Në rastin e situatave të jashtëzakonshme, me qëllim koordinimin e veprimeve për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, pranë ministrisë përgjegjëse krijohet njësia e koordinimit, si një strukturë *ad hoc*, që bashkëpunon me AKEP-in dhe autoritetet përgjegjëse për emergjencat, me qëllim koordinimin e veprimeve për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimit.

2. Ministria cakton një pikë kombëtare kontakti për të koordinuar me Bashkimin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), autoritetet përgjegjëse për emergjencat dhe partnerët ndërkombëtarë për të kërkuar ndihmë sipas nenit 11, në zbatim të Konventës Tampere.

3. Në rastet e jashtëzakonshme, Ministria dhe AKEP-i koordinojnë me sipërmarrësit dhe institucionet përgjegjëse për të siguruar vazhdimin e punës së sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe të punonjësve të tyre, që operojnë në terren, në veçanti për pajisjen me lejet e nevojshme, për:

a) kryerjen e punimeve në terren për linjat apo infrastrukturat e telekomunikacioneve;

b) lëvizjen e kontrolluar sipas një liste personeli dhe targash të automjeteve, të cilat do të jenë në shërbim të operacioneve në rast emergjencash;

c) mundësimin e aksesimit të infrastrukturës publike apo private, që shërben për menaxhimin, vazhdueshmërinë dhe rikthimin në normalitet të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Neni 14
Regjistri i operatorëve dhe i shërbimeve të autorizuara

AKEP-i, mbi bazën e informacioneve të sipërmarrësve dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike, krijon një regjistër të sipërmarrësve, që zotërojnë pajisje të lëvizshme telekomunikacioni, që mund të përdoren për rastet e situatave të jashtëzakonshme.

Neni 15
Testimet dhe auditimet

Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike organizojnë, të paktën 1 (një) herë në vit, testime ose simulime të kapaciteteve të telekomunikacionit në raste të situatave të jashtëzakonshme. Testimet dhe auditimet duhet të jenë të dokumentuara. Testimet dhe auditimet kryhen dhe me kërkesë e prezencë të përfaqësuesve të AKEP-it dhe/ose të ministrisë /autoriteteve përgjegjëse mbi bazën e një plani të koordinuar e të dakordësuar paraprakisht.

ANEKS 1

MODEL ORIENTUES PËR SIPËRMARRËSIT PËR PLANIN E MASAVE

Plani i masave për vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në raste të jashtëzakonshme

Për: _____
Sektori: Telekomunikacion/komunikime elektronike

1. Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky dokument përcakton politikat, procedurat dhe përgjegjësitë për rikuperimin e sistemeve kritike të rrjetit dhe të shërbimeve të komunikimeve të _____, në rast fatkeqësie ose ndërprerjeje të rëndë. Plani zbatohet për të gjitha sistemet, rrjetet dhe qendrat e të dhënave të operatorit, që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik për klientët.

2. Objektivat e planit

- Sigurimi i rikuperimit të shpejtë dhe të sigurt të funksioneve kritike pas një ndërprerjeje.
- Minimizimi i ndikimit ndaj përdoruesve (individë, biznes, autoritete publike) dhe i infrastrukturës kombëtare të komunikimit.
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore për sigurinë dhe me kërkesat kombëtare për vazhdimësinë e shërbimit.

3. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Ekipet përgjegjëse për zbatimin e PRF-së përfshijnë:

- ekipin e menaxhimit të krizës – koordinon përgjigjen e përgjithshme ndaj incidentit;
- ekipin teknik, të operimit e të mirëmbajtjes së rrjetit – zbaton procedurat teknike të rikuperimit;
- ekipin e vlerësimit të dëmtimeve;
- ekipin e komunikimit – menaxhon njoftimet publike dhe komunikimin me autoritetet;
- ekipin e sigurisë së informacionit – monitoron aspektet e sigurisë kibernetike gjatë rikuperimit.

4. Analiza e sistemeve kritike

Operatori _____ identifikon sistemet dhe shërbimet kritike, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e rrjetit kombëtar të telekomunikacionit, duke përcaktuar për secilin objektivat, për:

- kohën maksimale të pranueshme për rikuperim;
- kufirin maksimal të humbjes së të dhënave të pranueshme.

5. Strategjitë e kopjeve rezervë të të dhënave dhe të ruajtjes së të dhënave

- Kopjet rezervë të të dhënave kryhen çdo ditë për sistemet kritike dhe ruhen në një lokacion të sigurt jashtë sistemeve primare;
- Kopjet e të dhënave ruhen në *cloud* të sigurt brenda vendit dhe në një qendër alternative të të dhënave (*hot site*);
- Integriteti i kopjeve rezervë të të dhënave testohet periodikisht për të garantuar rikthimin e plotë të të dhënave.

6. Infrastruktura e rikuperimit

Operatori _____ mban kapacitete alternative operative për rikuperimin e shërbimeve:

- Qendër rezervë me pajisje të gatshme për aktivizim të menjëhershëm;
- Kapacitete të përgatitura pjesërisht për aktivizim brenda 24 orëve;
- Ambient rezervë pa pajisje, për raste ekstreme.

7. Procedurat e rikuperimit

Në rast fatkeqësie, aktivizohen procedurat e mëposhtme:

1. Vlerësimi i incidentit dhe njoftimi i menjëhershëm i ekipit të menaxhimit të krizës;

2. Aktivizimi i qendrës rezervë dhe rikthimi i serverave kritikë;

3. Rikthimi i bazave të të dhënave dhe lidhjeve të rrjetit;

4. Testimi i funksionimit të plotë para rifillimit të shërbimeve për publikun.

8. Plani i komunikimit dhe koordinimi

Operatori _____ mban linja të dedikuara komunikimi për situata emergjente dhe një plan komunikimi të krizës, që përfshin:

- informimin e autoriteteve rregullatore (AKEP, AKSK);

- komunikimin me klientët dhe partnerët për ndërprerjet;

- përdorimin e kanaleve alternative të komunikimit, në rast dështimi të rrjeteve primare.

9. Testimi dhe mirëmbajtja e planit

Plani testohet të paktën një herë në vit përmes simulimeve dhe ushtrimeve praktike. Pas çdo testi ose incidenti real, plani përditësohet në bazë të mësimeve të nxjerra. Verifikimet përputhen me kërkesat e NIS2 dhe udhëzimet e ENISA-s për testimin e qëndrueshmërisë së rrjeteve.

10. Aspektet ligjore dhe përputhshmëria

Ky plan është në përputhje me përcaktimet e ligjit për komunikimet elektronike dhe të ligjit për emergjencat civile, të ligjit për sigurinë kibernetike dhe rregulloret përkatëse të AKEP-it. Operatorët janë të detyruar të raportojnë incidentet madhore të sigurisë brenda 24 orëve nga identifikimi i tyre dhe të bashkëpunojnë me autoritetet për rikuperim të plotë.

11. Trajnimi dhe ndërgjegjësimi

Të gjithë punonjësit e përfshirë në zbatimin e PRF-së trajnohen periodikisht mbi procedurat e reagimit, të sigurisë së informacionit dhe komunikimit në situata emergjente. Operatori _____ organizon ushtrime praktike dhe verifikon gatishmërinë e personelit në çdo nivel.

Ky plan hyn në fuqi në datën _____ dhe rishikohet çdo 12 muaj.

ANEKS 2

MASAT PËR SIGURIMIN E VAZHDUESHMËRISË SE SHËRBIMEVE PARA, GJATË DHE MBAS SITUATAVE TË JASHTËZAKONSHME DHE DOKUMENTIMI

Masat e sigurisë	**Dokumentacioni**
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të implementojë një strategji për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit për rrjetet e komunikimit dhe sistemet e informacionit.	Strategjia/plani i dokumentuar për vazhdimësinë e shërbimit, duke përfshirë kohën e rikuperimit për shërbimet dhe proceset kryesore. Dokumentim i "Planit të vazhdimësisë së biznesit" (PVB).
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të implementojë dhe të zbatojë planet e emergjencës për sektorët dhe shërbimet kritike.	Planet e emergjencës për sistemet kritike, duke përfshirë hapa të qartë dhe procedurat për kërcënimet e njohura, shkaktuesit për aktivizimin, hapat dhe kohën e rikuperimit. Dokumentim i planit të rikuperimit pas fatkeqësisë PRF.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të monitorojë aktivitetet dhe zbatimin e planeve të emergjencës, regjistrimin e tentativave të suksesshme të rikuperimit dhe dështimet.	Dokumentimi që identifikon asetet dhe nyjat kritike të rrjetit.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të kryejë rishikimin dhe kontrollin periodik të strategjisë për vazhdimësinë e shërbimit.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka linja rezervë, servera pasivë, mjete komunikimi të bazuara në teknologjinë *cloud* dhe lidhje të pavarura për stacionet bazë dhe shërbimet kritike.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të testojë planet rezervë (*backup*) dhe të emergjencës për të siguruar që sistemet dhe proceset funksionojnë, dhe që personeli është i përgatitur në rastin e dëmtimeve të mëdha dhe emergjencave.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka pajisur qendrat e të dhënave, stacionet dhe antenat transmetuese me burime alternative të energjisë.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të implementojë një program për ushtrimin rregullisht të planeve rezervë dhe të	Dokumentimi që garanton funksionalitetin e numrit unik evropian të emergjencave "112" edhe pa kartë SIM, si dhe çdo numër kombëtar të emergjencës, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka marrë pjesë në ushtrime kombëtare simulimi të organizuara nga AKEP-i dhe institucionet përgjegjëse.

emergjencës, duke përdorur skenarë realistë, që mbulojnë një sërë skenarësh të ndryshëm me kalimin e kohës. -Përfshirja në ushtrime e furnitorëve dhe palëve të tjera të treta. -Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të rishikojë dhe të përditësojë planet, duke marrë në konsideratë ndryshimet, incidentet e mëparshme dhe emergjencat që nuk kanë qenë të mbuluara nga programi i ushtrimit. -Mësimet e nxjerra nga këto ushtrime të jenë adresuar nga personat përgjegjës dhe në përputhje me rrethanat të bëhet përditësimi i proceseve dhe sistemeve përkatëse.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka caktuar person kontakti në raste të jashtëzakonshme që komunikon me AKEP-in.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të përgatitet për rikthimin në gjendjen normale të sistemeve të komunikimeve elektronike. -Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të implementojë politika/procedura për vendosjen e kapaciteteve për rikuperimin e infrastrukturave të komunikimit elektronike.	Dokumentimi i aktivizimit dhe i zbatimit të planeve të emergjencës, duke përfshirë vendimet e marra, hapat e ndjekur, kohën e plotë të rikuperimit. Dokumentacion që sipërmarrësi ka parashikuar ngritjen e qendrës së reagimit të emergjencave ose ekipit/eve të brendshëm/me të emergjencës.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka përcaktuar sistem njoftimi për autoritetet përkatëse për çdo ndërprerje të shërbimeve.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka siguruar mjete të lëvizshme të rrjetit telefonik celular për t'u vendosur në terren.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka pajisur qendrat e të dhënave, stacionet dhe antenat transmetuese me burime alternative energjie.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka në përdorim rirutim automatik të lidhjeve përmes lidhjeve rezervë, përfshirë dhe ato ndërkombëtare. Përdorimi i sistemeve satelitore për mbulimin me sisteme komunikimi për autoritetet.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka siguruar akses për përdoruesit në shërbimet bazë emergjente (telefoni, 112, SMS).
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka transportuar gjatë krizës drejt AKEP-it dhe strukturave të tjera gjatë situatës.
	Strategjia e përditësuar e vazhdimësisë dhe planet e emergjencës, shqyrtimi i komenteve dhe/ose ndryshimi i *log*-eve. Dokumentacioni që sipërmarrësi ka bërë vlerësim e raportim për dëmet brenda 48 orëve pas ngjarjes.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka rikthyer funksionalitetin e rrjetit dhe të shërbimeve sipas planit të rikuperimit.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka kryer një analizë pas ngjarjes dhe ka raportuar me AKEP-in dhe institucionet e përcaktuara me ligj.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka përditësuar planet PVB/PRF dhe ka raportuar tek AKEP-i.
	Dokumentacioni që sipërmarrësi ka ndërtuar një manual praktik për përmirësim të kapaciteteve reaguese në të ardhmen.

ANEKS 3

MASAT PËR VAZHDUESHMËRINË E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NË RASTIN E SULMEVE KIBERNETIKE

Masat	**Dokumentacioni**
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike merr masat e duhura teknike, organizative dhe proporcionale për të menaxhuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet që vijnë për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve. Implementimi i monitorimit të *log*-eve për sistemet e informacionit.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka kryer vlerësime të rrezikut kibernetik çdo 12 muaj.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka në funksionim sisteme të monitorimit dhe të analizës (SIMNJ/QOS) për detektimin e anomalive.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka zbatuar arkitekturën "Zero besim", me akses të kufizuar sipas funksioneve.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të kryejë rishikime menaxheriale të menaxhimit të sigurisë së sistemeve, *log*-eve dhe raporteve të monitorimit të rrjeteve të komunikimit dhe të sistemeve të informacionit.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka kopje rezervë *offline* të sistemeve dhe të konfigurimeve kritike.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka kryer testime dhe simulime për skenarë emergjencash kibernetike.
-Implementimi i politikave të ngjarjeve dhe monitorimit të sistemeve.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka një plan të shkruar të reagimit ndaj incidenteve (PRI), të certifikuar nga AKSK-ja.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka sisteme njoftimi për institucionet e AKSK-së dhe AKEP-it, në rast incidenti.
-Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike duhet të rishikojë dhe të përditësojë politikat e procedurat, duke marrë parasysh ndryshimet dhe incidentet e mëparshme.	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka aktivizuar kanale të sigurta të komunikimit me autoritetet.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka kryer izolimin e pjesëve të kompromentuara të rrjetit dhe kontrollin e aksesit.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka kryer auditim forensik dhe analizë të plotë teknike të incidenteve.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka hartuar raportin e incidentit dhe e ka dorëzuar tek AKEP-i dhe AKSK-ja.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka rishikuar politikat e brendshme të sigurisë dhe trajnimit të stafit.
	Dokumentimi që tregon se sipërmarrësi ka përditësuar planet e vazhdimësisë së biznesit (PVB) dhe planet e reagimit ndaj incidenteve (PRI).

VENDIM
Nr. 280, datë 17.4.2026

PËR FORMËN, MËNYRËN DHE PROCEDURËN E RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit, që duhet të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar.

3. Për qëllim dhe zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Raport i aktivitetit të dyshimtë" (RAD), formulari që subjekti raportues, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, raporton tek autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, për çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi, për veprimtarinë nën juridiksionin e saj, sipas aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) "Raport i transaksionit të vlerave" (RTV), formulari që subjekti raportues, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, detyrohet ta plotësojë dhe ta raportojë, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve, regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës, me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, sipas aneksit II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton tek autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve, regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës, me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, sipas formularit RTV.

5. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton menjëherë dhe jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë pranë autoritetit përgjegjës, Agjencisë së Inteligjencës Financiare, çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi për veprimtaritë nën juridiksionin e vet, sipas formularit RAD.

6. Raportimet, sipas kërkesave të formularëve RTV dhe RAD, kryhen në rrugë elektronike, sipas formateve të përcaktuara në këtë vendim.

7. Në zbatim të këtij vendimi, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:

a) cakton në drejtorinë e përgjithshme një person që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

b) cakton një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në nivel administrimi ose drejtimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në çdo drejtori vendore të saj, ku të gjithë punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës raportojnë çdo fakt, që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash apo financim terrorizmi;

c) organizon procesin e monitorimit dhe siguron kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) ngarkon kontrollin e brendshëm për të monitoruar zbatimin e detyrimeve ligjore nga personat përgjegjës të caktuar për raportimin, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe të këtij vendimi;

d) merr masa administrative dhe bashkëpunon me autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për përgatitjen dhe organizimin e trajnimeve periodike të personave përgjegjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe tipologjitë përkatëse, që lidhen me këto fusha.

8. Personi përgjegjës ka këto kompetenca dhe detyra:

a) Analizon çdo të dhënë apo informacion, që është njoftuar si i dyshimtë, apo ka konstatuar nëpërmjet punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në funksion të dërgimit të RAD-it në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

b) Merr çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet, në përputhje me ligjin dhe këtë vendim;

c) Dërgon RAD-in në Agjencinë e Inteligjencës Financiare, nëse informacioni vlerësohet si i dyshimtë;

ç) Ruan konfidencialitetin në aktivitetin e kryer, në përmbushje të ligjit dhe të këtij vendimi;

d) Personi përgjegjës merr masa për zbatimin e masave parandaluese të përcaktuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar;

dh) Përgatit raport me shkrim, të paktën 1 (një) herë në vit, për procesin e monitorimit, në të cilin përfshin edhe numrin e raporteve të aktivitetit të dyshimtë të identifikuara dhe ia dorëzon atë drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

9. Personit përgjegjës dhe çdo punonjësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i ndalohet të informojnë personin ose çdo person tjetër për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për raportimin e aktivitetit të dyshimtë, si dhe për çdo informacion që kërkohet nga autoriteti përgjegjës apo për hetimet që janë duke u kryer.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës i kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës, jo më vonë se brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës për informacion.

11. Kur autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare, ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 (shtatëdhjetë e dy) orë, sipas dispozitave të ligjit, apo në rastet urgjente kur ka arsye të bazuar për pastrim parash apo financim terrorizmi dhe ka nevojë urgjente për informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, autoriteti përgjegjës i drejtohet zyrtarisht në formë të shkruar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Gjithashtu, kjo kërkesë brenda ditës së punës duhet të përcillet edhe në rrugë digjitale *online*, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale", të ndryshuar.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës i vë në dispozicion autoritetit përgjegjës informacionin apo dokumentacionin e kërkuar, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga paraqitja e kërkesës, apo nëpërmjet këqyrjes së informacionit në ambientet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nga personat e autorizuar të autoritetit përgjegjës.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të shkronjës "b", të nenit 22, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, dhe të pikës 6, të nenit 28, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i ofron akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave autoritetit përgjegjës, Agjencisë së Inteligjencës Financiare. Kërkesat për shërbime kadastrale (kërkesë për informacion dhe dokumentacion) ofrohen pas paraqitjes së kërkesës në rrugë digjitale *online*, në përputhje me parashikimet e nenit 63, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", duke iu nënshtruar procedurave të parashikuara në vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale", të ndryshuar.

13. Ky vendim, së bashku me anekset I, II dhe instruksionet përkatëse, janë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek autoriteti përgjegjës.

14. Udhëzimi nr. 1, datë 1.4.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të të dhënave të subjekteve, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", shfuqizohet.

15. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

Aneksi I
RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni kutinë me kombinime:
□ Pastrim parash □ Financim i terrorizmit □ Fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale □ Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së duhur □ Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së zgjeruar
2. Zgjidhni kutinë me kombinime:
□ Raport i ri □ Raportimet të lidhura □ Përmirëson një raport të mëparshëm □ Transfertë në tentativë
PJESA I. INFORMACION PËR AKTIVITETIN E DYSHIMTË
1.Statusi ligjor i personit a.☐ Individ; b.☐ Person fizik tregtar c. ☐ Person juridik d.☐ Shoqëri anonime e. ☐ OJF; f. ☐ Organizime ligjore g.☐ SH.P.K. (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) h. ☐ Kujdestar i.☐ Degë e shoqërisë së huaj; j.☐ PEP; k. ☐Tjetër 2. a) Emri:_____ b. Atësia[1]:_____ c. Mbiemri:_____ 3. Datëlindja/data e regjistrimit: __.___._____ 4. Shtetësia: a. ☐Shqiptar b.☐I huaj 5. Vendlindja: _____ 6.Vendbanimi i përkohshëm (nëse ka):_____7. Gjinia : a. ☐Mashkull; b.☐Femër
8. Dokumenti i identifikimit: a) □ Letërnjoftim b) □ Pasaportë 9. Numri i dokumentit:_____ 10. Nr. personal i identifikimit (NID):_____ 11.Autoriteti lëshues:_____
12. Emërtimi i subjektit:_____ 13. NUIS/NIPT:_____ 14. Adresa e themelimit:_____ 15. Adresa e përkohshëm (nëse ka):_____;
PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË
PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER
1. Data e kryerjes së transaksionit ____,____,_____ 2. Monedha: Lek☐ Euro☐ USD☐ GBP☐ JPY☐ CHF☐ CAD☐ Tjetër☐ 3. Shuma e transaksionit: _____
PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

[1]Atësia kur deklarohet

Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë: *Shënim: Të strukturohet sipas pikave të mëposhtme:* 1. Përshkrimi i profilit të subjektit të RAD-it; 2. Analiza e rastit, duke përshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve; 3. Anomalitë e vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta; 4. Dyshimet për rastin; 5. Lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka; 6. Nëse kërkohen udhëzime nga AIF-ja; 7. Të dhëna apo informacione të tjera me interes.
PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE
PJESA VI. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES:
Emri: _____ Data e raportimit:___._____._____ Personi përgjegjës: _____ Tel._____ Firma: _____ *E-mail*:_____ Aprovuesi: _____ Adresa: _____

INSTRUKSIONE
PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT
"RAPORTI I AKTIVITETIT TË
DYSHIMTË" (RAD)

HYRJE

"Raporti i aktivitetit të dyshimtë" (RAD) është formulari, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me anë të të cilit subjekti raporton tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjekti për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale dhe financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale.

Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash, financim të terrorizmit apo fondet rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse dërgohet tek AIF-ja një raport i ri, një transfertë në tentativë apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I. INFORMACION PËR AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. Statusi ligjor i personit: Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë, sipas rastit, individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, OJF, organizime ligjore, sh.p.k. (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj, të tjera.

2. Emri, atësia, mbiemri: Për individin shkruhen emri, atësia dhe mbiemri. Atësia plotësohet kur deklarohet.

3. Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv): Nëse personi, në emër të të cilit kryhet transaksioni/et, është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 3.4.1978.

4. Shtetësia: Shkruhet shtetësia e personit që

kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. Vendlindja: Shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur.

6. Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka): Plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

7. Gjinia: a) Mashkull; b) Femër: Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas rastit, nëse individi është mashkull apo femër.

8. Dokumenti i identifikimit: a) □ letërnjoftim; b) □ pasaportë; c) □ nr. personal (NID);

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse, sipas llojit të dokumentit të përdorur, për të bërë identifikimin e personit.

9. Numri i dokumentit: Këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.

10. Numri personal i identifikimit. Këtu shkruhet numri personal i identifikimit.

11. Autoriteti lëshues: Këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

12. Emërtimi i subjektit: Këtu shkruhet emri i subjektit.

13. NUIS/NIPT: Shkruhet numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

14. Adresa e themelimit: Shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

15. Adresa e përkohshme (nëse ka): Plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhënat për personat e përfshirë në transaksion.

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. Data e kryerjes së transaksionit: Data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke, p.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 5.5.2008.

2. Monedha: Vihet një kryq në një prej kutive, sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit, p.sh.: LEK, USD, GBP, EUR etj.

3. Shuma e transaksionit: Shkruhet shuma në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit, subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim. Limiti i karaktereve është vendosur për të siguruar përditësimin e informacioneve voluminoze, që hyjnë në databazë, p.sh.: tabela, figurë, materialet për këtë limit mund të përcillen të zipuara te pjesa V, si më poshtë.

PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Në këtë pjesë të raportit vendosen të zipuara (deri në 10.MB ZIP) dokumentet që shoqërojnë raportin.

PJESA VI. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave apo emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e *email*-it, si dhe adresën e personit përgjegjës, me anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKSI II
RAPORTI I TRANSAKSIONIT TË VLERAVE (RTV)
(Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 milionë lekë)

Zgjidhni kutinë e duhur:	
☐Raportim i ri	☐Përmirëson një raportim të mëparshëm
☐Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri	☐Transaksione të lidhura

PJESA I. PALËT E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION
SEKSIONI A – PALA SHITËSE/DHURUESE/TJETËR

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/NUS _____

d) Pjesa takuese _____

SEKSIONI B
PALA BLERËSE/PRANUESE E DHURIMIT/TJETËR

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/NUS _____

d) Pjesa takuese _____

PJESA II. INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET

Nr. rep.: _____ Nr. kol.: _____ Data e transaksionit: ___.____._____

Data e kalimit të pronësisë: _____
Lloji i pasurisë (apartament, arë etj.) _____
Sipërfaqe: _____
Adresa e pasurisë: _____
Nr. i pasurisë:_____
Zona kadastrale:_____

Shuma: _____ Zgjidhni monedhën: LEK ☐ EUR ☐ USD ☐ Tjetër _____

PJESA III. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i institucionit _____

Adresa: _____
Personi përgjegjës: _____
Data e raportimit: ___.____._____

Tel: _____

Adresë *e-mail*-i: _____

(NIPT): _____

TË PLOTËSOHET NËSE NË TRANSAKSION JANË TË PËRFSHIRË MË SHUMË SE NJË INDIVID/SHOQËRI

PJESA I. PALËT E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION

SEKSIONI A – PALA SHITËSE

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/ NUS _____
d) Pjesa takuese _____

SEKSIONI B – PALA BLERËSE

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i subjektit _____ ç) NID/ NUS _____
d) Pjesa takuese _____

PJESA II. INFORMACION PËR TRANSAKSIONIN/ET

Nr. rep.: _____ Nr. kol.: _____ Data e transaksionit: ___.____._____
Lloji i transaksionit: _____

Lloji i pasurisë, objekt i kontratës/transaksionit: _____

Shuma: _____ Zgjidhni monedhën: LEK ☐ EUR ☐ USD ☐ Tjetër _____

PJESA III. INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

a) Emri_____ b) Mbiemri_____

c) Emërtimi i institucionit _____

Adresa: _____
Personi përgjegjës: _____

Tel: _____
Data e raportimit: ___.____._____

Adresë *e-mail*-i: _____

(NIPT): _____

VENDIM
Nr. 281, datë 17.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren, që i bashkëlidhet vendimit nr. 752, datë 19.12 2018, të Këshillit Ministrave, "Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale", të ndyshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të BA-së është i barabartë me shumën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë për çdo mbledhje, por, në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.".

2. Pika 3, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Shpërblimi i sekretarit teknik është i barabartë me shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por, në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.".

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

III. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VeNDIM
Nr. 283, datë 17.4.2026

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME "ANSAMBËL ARKITEKTONIK URBAN" TË NJË ZONE NË QYTETIN E DELVINËS, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE TË TIJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 9, dhe të pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambël arkitektonik urban" të një zone në qytetin e Delvinës, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone në qytetin e Delvinës, sipas hartës dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e "Ansamblit arkitektonik urban" të qytetit të Delvinës dhe zonës mbrojtëse të tij në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe me aktet nënligjore në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Delvinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E "ANSAMBLIT ARKITEKTONIK URBAN" DHE ZONËS MBROJTËSE TË TIJ NË QYTETIN E DELVINËS

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij në qytetin e Delvinës, si dhe kufijtë e tyre.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij plani janë:

1. Administrimi i "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të qytetit të Delvinës, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë integrale e tij;

2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave arkitektoniko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të "Ansamblit arkitektonik urban" të qytetit të Delvinës;

3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të "Ansamblit arkitektonik urban" të qytetit të Delvinës dhe zonës mbrojtëse të tij.

Neni 3
Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Delvinës përbëhet nga:

a) ansambli arkitektonik urban;

b) zona mbrojtëse.

2. Brenda këtyre zonave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen pasuri kulturore, objekte shoqërore, banesa tradicionale, të lidhura ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, zona të gjelbra, sheshe dhe rrjeti rrugor, me prezencë kalldrëmi.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Delvinë merr parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse përreth tij.

Neni 4
"Ansambli arkitektonik urban" dhe kufijtë e tij

1. "Ansambli arkitektonik urban" i qytetit të Delvinës është hapësira urbane, me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit arkitektonik të qytetit dhe arritjet në arkitekturë dhe në urbanistikë.

2. Kufijtë e "Ansamblit arkitektonik urban" paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Delvinës, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar – KRGJSH paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5
Zona mbrojtëse e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe kufijtë e tij

1. Zona mbrojtëse ruan vlera arkitektoniko-kulturore dhe të peizazhit, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të lira të qytetit.

2. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Delvinës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar – KRGJSH paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6
Ndërhyrjet e lejuara në "Ansamblin arkitektonik urban"

1. Ndërhyrjet në "Ansamblin arkitektonik urban" kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, arkitektonike, urbanistike të qytetit të Delvinës.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të "Ansamblit arkitektonik urban", brenda kësaj zone lejohen:

a) ndërhyrje sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) ndërhyrje restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale;

c) rikonstruksioni/rindërtimi i ndërtesave mbi strukturat ekzistuese duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve dhe kriteret e përcaktuara në këtë plan;

ç) në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, mundësia e kryerjes së rikonstruksionit/rindërtimit mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;

d) ndërtimet e reja në sheshet e lira, që u nënshtrohen kritereve të përcaktuara në këtë plan. Leja e ndërtimit jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit dhe legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore;

dh) në rastet e objekteve me ndërhyrje ekzistuese jo në harmoni me ndërtimet e zonës, mundësia e kryerjes së rehabilitimit të tyre, duke u bazuar në karakteristikat tradicionale.

Neni 7
Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban"

1. Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse janë:

a) sistematike të mirëmbajtjes, konservuese, restauruese;

b) rikonstruksione, rindërtime dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës dhe në respekt me kriteret e këtij plani;

c) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

ç) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

d) rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale;

dh) të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale;

e) të modifikimit të gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës, brenda së cilës ndodhet rruga. Në rastet kur gjurma e rrugës, në të cilën ndërhyhet, shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

2. Në zonën ku ndodhet monumenti i natyrës "Rrepet e Delvinës", të gjitha ndërhyrjet i nënshtrohen regjimit juridik, sipas ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar.

Neni 8
Ndërhyrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës, të cilat ndodhen brenda "Ansamblit arkitektonik urban" të një zone të qytetit të Delvinës kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave, për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Ndërhyrjet e lejuara janë:

a) sistematike të mirëmbajtjes, konservuese, restauruese;

b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 9

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij

1. Në hapësirën e "Ansamblit arkitektonik urban" nuk lejohen:

a) instalime që paraqesin rreziqe ose janë të një natyre të rrezikshme, që mund t'u shkaktojnë;

b) dëme të rënda ose të pandreqshme njerëzve, pasurive, natyrës dhe peizazhit;

c) terrene sportive (me sipërfaqe mbi 200 m^2);

ç) struktura industriale;

d) gurore.

2. Në hapësirën e zonës mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" nuk lejohen:

a) struktura industriale;

b) guroret.

Neni 10

Objektet pa status, pjesë e "Ansamblit arkitektonik urban"

Objektet pa status, pjesë e "Ansamblit arkitektonik urban", janë objekte të ndërtuara deri në miratimin e këtij plani, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të tij.

Neni 11

Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe zonën mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse të tij, të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, rikonstruksione dhe rindërtime, duhet të kenë qëllim rritjen e vlerave dhe përshtatjen me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës.

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve ekzistuese në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe zonën mbrojtëse të tij hartohen në varësi të vlerave arkitektoniko-kulturore të objektit, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Projektet për rikonstruksionin e objekteve mbi strukturat ekzistuese dhe ndërtimet e reja në sheshet e lira brenda "Ansamblit aarkitektonik urban" hartohen:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë dhe teknikën tradicionale;

b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke respektuar kushtin që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy–tri kateve ose 10.5 m deri në kornizën e çatisë;

d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

dh) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative katërujëse, me pjerrësi 25–30 gradë, mbuluar me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja brenda zonës mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" hartohen bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Delvinë apo studimeve urbanistike e arkitektonike, duke respektuar kriteret, si vijon:

a) Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t'i kalojë 3–4 katet dhe lartësinë 12.5 m deri në kornizën e çatisë;

b) Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet

t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.;

c) Çatitë duhet të jenë katërujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore brenda "Ansamblit arkitektonik urban" dhe zonës mbrojtëse hartohen:

a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Delvinë;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 12

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe zonën mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Ansamblit arkitektonik urban" apo zonës mbrojtëse të tij dhe të cilat përcaktojnë objektet, ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, rikonstruksione apo rindërtime, hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK-ja), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (në vijim DRTK-ja) përgjegjëse për qytetin e Delvinës ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Studimet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim KKTKM-ja).

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rijetëzimin në "Ansamblin arkitektonik urban" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve në gjurmët ekzistuese dhe ndërtimet e reja në sheshe të lira, brenda "Ansamblit arkitektonik urban", hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin, rikonstruksionet, rindërtimet dhe ndërtimet e reja në zonën mbrojtëse të "Ansamblit arkitektonik urban" hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Delvinë apo studimeve urbanistike e arkitektonike. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohen nga DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në "Ansamblin arkitektonik urban" dhe zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në "Ansamblin arkitektonik urban" hartohen nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për qytetin e Delvinës.

Neni 13
Dispozitat e fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave

.



Nr.	X	Y
1	508556.73472837	4423699.79069
2	508569.406416384	4423694.13717
3	508601.9629071276	4423696.96393
4	508617.94872893	4423700.57049
5	508628.573451957	4423708.07602
6	508636.0789902422	4423713.24217
7	508639.588073077	4423725.52396
8	508649.0431018258	4423736.44111
9	508659.0829777138	4423737.02596
10	508696.9030927094	4423687.119
11	508698.0727869876	4423680.10084
12	508704.603580041	4423667.91652
13	508711.0368985712	4423643.74284
14	508713.7661852204	4423631.75347

15	508710.7444750016	4423631.94842
16	508712.6939654654	4423621.90854
17	508716.9828444854	4423620.44643
18	508721.3691980288	4423614.59796
19	508725.0732299098	4423602.12122
20	508707.8202393062	4423595.98032
21	508695.2460258154	4423588.86468
22	508701.4843952992	4423584.86823
23	508706.065697889	4423574.2435
24	508709.76972977	4423562.25414
25	508713.4737616512	4423548.12033
26	508713.7661852208	4423537.10571
27	508693.4914843984	4423537.30066
28	508680.4298982916	4423542.66176
29	508649.0431018262	4423535.05874
30	508643.7794775742	4423540.02995
31	508628.5734519574	4423532.03703
32	508623.8946748446	4423531.84209
33	508622.9199296126	4423567.12786
34	508595.627063121	4423572.78139
35	508569.4064163842	4423579.2147
36	508547.4746486678	4423577.75259
37	508519.7918840832	4423557.18546
38	508506.53534893	4423553.28648
39	508501.3691992012	4423558.74505
40	508465.4985746696	4423569.36978
41	508441.0324693502	4423581.55409
42	508410.327994547	4423595.98032
43	508388.5911758768	4423597.63739
44	508362.4680036634	4423621.22622
45	508351.6483315898	4423651.44333
46	508360.0311405838	4423661.8731
47	508364.1250705576	4423675.12963
48	508365.2947648358	4423705.34674
49	508363.1503253258	4423710.22046
50	508377.2841311874	4423717.53105
51	508386.1543127972	4423720.94266
52	508392.880054897	4423728.64315
53	508400.9704403214	4423733.8093
54	508432.357236787	4423741.99716
55	508442.7870107676	4423745.50624
56	508457.9930363846	4423748.52795
57	508468.0329122726	4423754.76632
58	508487.0404442936	4423751.15976
59	508520.6691547922	4423748.04058
60	508526.4201516602	4423737.22091
61	508539.1893141974	4423718.99317
62	508556.73472837	4423699.79069

Nr.	X	Y
1	508504.22033	4423941.99051
2	508473.58896	4423924.88373
3	508419.68555	4423897.88329
4	508419.68555	4423889.7929
5	508472.37053	4423866.20407
6	508484.94474	4423864.44953
7	508496.398	4423862.40256
8	508512.23761	4423859.5758
9	508541.28502	4423856.21293
10	508566.43344	4423851.87531
11	508585.09981	4423857.01709
12	508610.54067	4423851.656
13	508643.34084	4423874.31882
14	508697.53668	4423872.56428
15	508695.00234	4423843.61435
16	508735.16184	4423845.17394
17	508744.61687	4423842.15223
18	508719.85834	4423820.12299
19	508673.46047	4423762.71049
20	508683.64656	4423751.93956
21	508681.59959	4423746.52972
22	508690.66472	4423738.97545
23	508698.219	4423734.73531
24	508703.28767	4423728.20451
25	508711.18311	4423732.20097
26	508757.77593	4423733.27319
27	508763.52693	4423723.91563
28	508749.58807	4423720.2116
29	508765.37895	4423702.08134
30	508749.97797	4423691.55409
31	508750.95272	4423687.07026
32	508764.0143	4423681.80664
33	508762.25976	4423670.01222
34	508764.50167	4423665.91829
35	508762.06481	4423662.40921
36	508761.96734	4423630.68125
37	508756.11887	4423619.08178
38	508756.26508	4423608.74948
39	508772.73827	4423592.27629
40	508759.62795	4423574.43845
41	508762.99082	4423566.7867
42	508768.64434	4423550.06982
43	508768.83929	4423541.73575
44	508771.66605	4423536.08223
45	508770.83752	4423520.4863
46	508762.84461	4423517.46459
47	508754.51054	4423512.88329

48	508746.12773	4423503.62321
49	508741.54642	4423507.13229
50	508731.89645	4423498.06716
51	508734.82068	4423494.55808
52	508735.30805	4423482.66619
53	508731.7015	4423477.20762
54	508735.79543	4423472.91874
55	508745.25046	4423465.70562
56	508754.90043	4423460.442
57	508755.09538	4423448.55011
58	508737.25755	4423449.81727
59	508729.65453	4423448.06273
60	508719.61466	4423446.99051
61	508706.74802	4423442.70163
62	508696.1233	4423440.36225
63	508680.8198	4423438.6077
64	508666.78347	4423438.41275
65	508649.0431	4423439.3875
66	508645.19286	4423417.45573
67	508654.20925	4423404.1992
68	508660.88626	4423393.477
69	508653.18577	4423390.74771
70	508638.54022	4423387.21426
71	508627.57434	4423382.24306
72	508617.38825	4423377.36933
73	508604.32666	4423366.45219
74	508557.34394	4423384.7774
75	508527.61421	4423394.62233
76	508519.71878	4423395.01222
77	508512.70061	4423400.37332
78	508502.07589	4423404.75968
79	508453.24115	4423427.08134
80	508465.03557	4423443.65201
81	508463.71966	4423503.35516
82	508454.06969	4423515.53947
83	508456.50655	4423522.65511
84	508445.10203	4423529.77075
85	508431.8455	4423539.9081
86	508411.37585	4423546.63384
87	508395.0976	4423549.36313
88	508369.0719	4423553.06716
89	508337.97753	4423557.64847
90	508300.54731	4423582.60194
91	508252.3949	4423574.02419
92	508246.74138	4423578.60549
93	508239.62574	4423588.64536
94	508234.26464	4423592.64182
95	508224.02981	4423599.85493

96	508215.25711	4423606.67815
97	508205.50965	4423616.4256
98	508198.78391	4423626.95285
99	508198.29654	4423640.01444
100	508192.93544	4423650.73664
101	508191.47332	4423663.40832
102	508197.90664	4423679.10172
103	508219.64346	4423689.92139
104	508229.97576	4423692.06583
105	508244.98683	4423699.76632
106	508287.5832	4423748.99095
107	508257.756	4423763.90456
108	508297.23318	4423828.14027
109	508284.26907	4423835.64581
110	508282.31958	4423835.74328
111	508236.84771	4423857.52884
112	508236.3116	4423859.67328
113	508223.00633	4423867.13008
114	508269.89158	4423943.74505
115	508291.53092	4423972.88993
116	508295.13748	4423970.55055
117	508373.60447	4424056.23065
118	508414.15387	4424029.32768
119	508463.67093	4423995.01665
120	508504.22033	4423941.99051

VENDIM
Nr. 284, datë 17.4.2026

PËR DEKLARIMIN "PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME" TË ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" TË BUSHATIT, BASHKIA VAU I DEJËS, DHE MIRATIMIN E ZONIFIKIMIT E TË PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN E ADMINISTRIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat "a" dhe "ç", e 53, pika 3, shkronja "b", nënndarja "iv", të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin "Pasuri kulturore e paluajtshme" të zonës arkeologjike "A" të Bushatit, Bashkia Vau i Dejës.

2. Miratimin e zonifikimit të zonës arkeologjike "A" të Bushatit, Bashkia Vau i Dejës, sipas koordinatave dhe hartave të zonifikimit në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e kësaj zone, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi në hartat kadastrale, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e zonës arkeologjike "A" të Bushatit në Gjeoportalin Kombëtar.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Vau i Dejës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN E ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A" TË BUSHATIT, BASHKIA VAU I DEJËS

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e zonës arkeologjike "A" të Bushatit, si dhe përcaktimin e kufijve të saj, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij plani është:

a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe të peizazhit të zonës arkeologjike "A";

b) administrimi i zonës arkeologjike "A";

c) mënyra e bashkëpunimit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të institucioneve të specializuara të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës arkeologjike "A" të Bushatit.

Neni 3
Hapësira arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira në mbrojtje me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e Bushatit përbëhet nga zona arkeologjike "A", që përkon me qytetin antik të Bushatit, në Bashkinë e Vaut të Dejës.

2. Kufijtë e zonës arkeologjike "A" paraqiten në hartën e zonifikimit, shoqëruar me koordinatat gjeografike në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë së Vaut të Dejës merr në konsideratë kufijtë e zonifikimit të zonës arkeologjike "A", të Bushatit, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e saj.

Neni 4
Ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A"

1. Në zonën arkeologjike "A" të Bushatit lejohen vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, KKTKM-ja);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, hulumtime arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore-shkencore të miratuara nga struktura përgjegjëse pranë institucioneve shkencore, të përcaktuara në ligjin nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, pas shqyrtimit dhe miratimit në KKTKM;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe i të gjitha punimeve në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara në KKTKM;

d) vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojat e tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë vijon:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të cenojnë nëntokën e peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet në KKTKM dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen e vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e konstruksioneve duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara;

iv. kohëzgjatja e konstruksioneve duhet të jetë sezonale, jo më tepër se 1 (një) vit.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A" të Bushatit, të parashikuara në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM dhe më pas vijojnë procedurën, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 5
Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A"

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike "A" të Bushatit, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton e vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 4, të këtij plani, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku, në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK-ja).

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 4, të këtij plani, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:

a) format e testimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 4, të këtij plani, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonën arkeologjike "A" realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara për veprimtari arkeologjike dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

Neni 6
Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paautorizuara në zonën arkeologjike "A" të Bushatit

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paautorizuara brenda zonës arkeologjike "A", Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për territorin, ku ndodhet

fshati Bushat, ka detyrimin të ndërmarrë masat ligjore për ndërprerjen menjëherë të veprimtarisë së subjektit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) përkatëse njofton menjëherë Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret menjëherë veprimtarinë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) përgjegjëse për territorin, ku ndodhet fshati Bushat, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore për marrjen e masave përkatëse në zbatim të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 7
Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Klasifikohen si gjetje rastësore arkeologjike objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet e tyre arkeologjike dhe strukturat arkitektonike, sipas parashikimeve të nenit 144, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

2. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonën arkeologjike "A", punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145 të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

3. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

4. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147 dhe 260, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 8
Vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike "A" lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe e paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë pamjen, peizazhin dhe integritetin e monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmive dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së përgjegjëse për territorin, ku ndodhet fshati Bushat, pas njoftimit zyrtar nga Bashkia Vau i Dejës.

4. Tabelat e sinjalistikës rrugore/turistike duhet të jenë në gjuhën shqipe, si dhe në një gjuhë me përhapje më të gjerë ndërkombëtare.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të pasurive kulturore dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 9
Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.


N
1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
0 100 200 m
Kufiri i propozuar për "Zonën Arekologjke 'A'" të sitit arkeologjik të Bushatit.

KOORDINATAT E ZONËS ARKEOLOGJIKE "A"
BUSHAT (KRGJSH 2010)

Nr.	X	Y
12	462147.56866093	4649512.07718597
13	462142.447249083	4649487.21978422
11	461989.047060896	4649698.23378149
14	461982.506206772	4649595.33591803
15	461965.131794072	4649567.84468713
16	461909.787522973	4649276.3394309
10	461860.277002832	4649927.01060957
17	461817.079260273	4649221.5005234
9	461707.146092558	4649964.19435667
7	461681.833272943	4650072.56197882
8	461658.320547482	4650035.34611612
6	461649.694472769	4650109.30801584
5	461629.220132628	4650096.29501885
4	461479.783971104	4650219.68814121
3	461447.385584021	4650321.49097645
2	461337.266280049	4650428.81132004
1	461021.172937672	4650101.58818322

VENDIM
Nr. 287, datë 17.4.2026

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2026, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është 61 (gjashtëdhjetë e një) pozicione të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues dhe për nivelin e ulët drejtues, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

Lidhja 1

POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm

1. Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave në Kryeministri;

2. Koordinator në Drejtorinë e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve në Njësinë për

Integrimin Evropian në Departamentin e Politikës dhe Integrimit Evropian në Kryeministri;

3. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

4. Koordinator në Sektorin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në Drejtorinë e Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

5. Drejtor i Drejtorisë së Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

6. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes;

7. Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit dhe Menaxhimit të Projekteve në Fushën e Artit dhe Kulturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Artit, Kulturës dhe Rinisë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

8. Drejtor i Drejtorisë e Administrimit të Fondit të Trashëgimisë Kulturore dhe Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

9. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Hartimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

10. Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave për Turizmin, Kulturën, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

11. Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;

12. Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar në Ministrinë e Financave;

13. Drejtor i Zyrës (Drejtoria) Mbështetëse ZKA në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave;

14. Drejtor i Departamentit Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

15. Drejtor i Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;

16. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

17. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

18. Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Regjistrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

19. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

20. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

21. Drejtor i Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimit Ndërgjyqësor në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë;

22. Drejtor i Drejtorisë së Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë;

23. Drejtor i Drejtorisë së Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

24. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, Emergjencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

25. Drejtor i Drejtorisë së Inovacionit dhe Inteligjencës së të Dhënave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

26. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

27. Drejtor i Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI);

28. Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Mjedisit;

29. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

30. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Aftësimit Profesional dhe Inspektimit AFP në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

31. Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Koordinator në Drejtorinë e Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve në Njësinë për Integrimin Evropian në Departamentin e Politikës dhe Integrimit Evropian në Kryeministri;

2. Analist në Sektorin e Kërkimeve në Drejtorinë e Programimit Strategjik në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

3. Përgjegjës i Sektorit të Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit;

4. Përgjegjës i Sektorit të Arsimimit, Kualifikimit dhe Zhvillimit të Karrierës së Personelit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mbrojtjes;

5. Drejtor i Agjencisë Rajonale të Bregdetit Vlorë;

6. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Inspektimit të Zonave Bregdetare dhe Veprimtarive Turistike në Agjencinë Rajonale të Bregdetit Lezhë;

7. Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Biznesit në Drejtorinë e Implementimit të Operacioneve Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

8. Përgjegjës i Sektori të Taksimit të Dyfishtë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

9. Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Gjyqësore në Drejtorinë e Trajtimit të Ankesave, Marrëdhënieve me Institucionet dhe Çështjet Juridike në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

10. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Administratën e Prefektit të Qarkut Durrës;

11. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Administratën e Prefektit të Qarkut Shkodër;

12. Përgjegjës i Sektorit të Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjeve në Drejtorinë e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

13. Përgjegjës i Sektorit të Produkteve Veterinare dhe Mbetjeve në Drejtorinë e Politikave Veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

14. Përgjegjës i Sektorit të Bazës Eksperimentale/Prodhuese në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë;

15. Koordinator në Sektorin e së Drejtës Ekonomike, Financiare, Industriale dhe Sipërmarrjes në Drejtorinë e së Drejtës Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë;

16. Ekspert Mjeko-Ligjor (pranë qarkut Gjirokastër) në Sektorin e Ekspertizës Mjekoligjore pranë Qarqeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

17. Ekspert Mjeko-Ligjor (pranë qarkut Korçë) në Sektorin e Ekspertizës Mjekoligjore pranë Qarqeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

18. Ekspert Mjekoligjor në Sektorin e Ekspertizës Mjeko-Ligjore, Kërkimit Shkencor dhe Specializimeve në Institutin e Mjekësisë Ligjore;

19. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Zhvillimit të Shërbimit Spitalor në Drejtorinë e Politikave të Shërbimit Spitalor në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

20. Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes ndaj Dhunës në Familje në Drejtorinë e Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Mirëqenien Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

21. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve Financuar nga Donatorët e Tjerë në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

22. Përgjegjës i Sektorit të Digjitalizimit në Drejtorinë e Transformimit Digjital në Drejtorinë e Përgjithshme të Inovacionit dhe Teknologjisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit;

23. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit nr. 1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

URDHËR
Nr. 403, datë 15.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Płoniawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytoń*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*

66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Gołuchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81.	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82.	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83.	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84.	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85.	Śląskie	Mikołów	Mikołów*
86.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
87.	**Kujawsko-Pomorskie**	**Aleksandrów**	**Aleksandrów Kujawski (rural)***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 380, datë 7.4.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", dhe urdhri nr. 400, datë 14.4.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohen.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 405, datë 16.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KOSOVËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi nga i gjithë shteti i Kosovës.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24-orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 406, datë 16.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Warmińsko-Mazurskie	Iława	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Iława	Iława (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Iława	Zalewo*
11.	Malopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcin	Krzeszyce*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Blotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Żuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Poddębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Słupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Małomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemień*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wohyń*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
42.	Wielkopolskie	Turek	Brudzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęczyno*
45.	Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzany*

51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Legnica	Prochowice*
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Nad Prosną*
54.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
55.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Janikowo*
56.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
57.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
58.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Kruszwica*
59.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Lwówek*
60.	Wielkopolskie	Leszno	Włoszakowice*
61.	Łódzkie	Brzeziny	Jeżów*
62.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
63.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
64.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
65.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
66.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
67.	Mazowieckie	Mława	Strzegowo*
68.	Mazowieckie	Żuromin	Kuczbork-Osada*
69.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
70.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
71.	Mazowieckie	Płońsk	Baboszewo*
72.	**Wielkopolskie**	**Kalisz**	**Brzeziny***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 398, datë 14.4.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/04/22 14:37:34 +02'00'
30bf740199ee475cb691a2ffe7cc27842

Çmimi 224 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)